



REPUBLIKA E SHQIPËRISE



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 174/4 Prot.

Shkodër, më 17/03 / 2025

VENDIM

Nr. 05, Datë 13.03.2025

“PËR DISA NDRYSHIME NË VKQSHKODËR NR. 27, DATË 20.12.2024 -PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, KATEGORITË/KLASAT PËR ÇDO POZICION, PAGAT DHE NUMRIN E PUNONJËSVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2025”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 13.03.2025, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për disa ndryshime në VKQShkodër nr. 27, datë 20.12.2024 -për miratimin e strukturës organizative, kategoritë/klasat për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të administratës së këshillit të qarkut shkodër për vitin 2025”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 ‘Për Nëpunësin Civil’ (i ndryshuar); nenin 15 të Ligjit nr.115/2024 “Për buxhetin e vitit 2025” VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr.503, datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.05.2023 të KM...” Ligjin nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, pika 119 e Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025”, VKQ nr.27, datë 20.12.2024, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë

së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me **12 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,**

VENDOSI:

Pika 1 e VKQShkodër nr.27, datë 20.12.2024 bëhet;- Të miratojë Strukturën Organizative , kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion, pagat dhe numrin e punonjësve, të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2025, me gjithsejt 16 (gjashtë mbëdhjetë) punonjës, 3 (tre) të zgjedhur dhe 13(Trembëdhjetë) punonjës administrativ, sipas tabelës bashkangjitur.

2. Pika 2 e VKQShkodër nr.27, datë 20.12.2024 bëhet;- Efektet financiare, do të përballohen nga;
 - Fondet sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2025 (Transferte e pakushtëzuar, sektoriale dhe fonde të trashëguara nga viti 2024);
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

